



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat e Llogarive Kombëtare

Llogaritë Qeveritare 2020-2024





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat e Llogarive Kombëtare

Llogaritë Qeveritare 2020 - 2024



Prishtinë, 02.05.2025 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës për periudhën 2020 - 2024. Ky publikim është përgatitur në përputhje me Udhëzuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për Statistikat e Financave Qeveritare (GFSM 2014) dhe Sistemin e Llogarive Evropiane (ESA 2010)*. Publikimi paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ASK-ja i është mirënjohëse Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit dhe Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Fatmir Morina - Drejtor i Departamentit të Statistikave të Llogarive Kombëtare

Edona Rexhepaj - Udhëheqëse e Divizionit të Ekonomisë Joformale dhe Llogarive Qeveritare

Fatlie Mazreku - Zyrtare e lartë e Llogarive qeveritare

Ilir Mazrekaj - Zyrtar i lartë i Llogarive qeveritare

Vjosa Prekazi - Zyrtare e Llogarive qeveritare

Maj, 2025

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së
Avni Kastrati

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
COFOG	-	Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit
ESA2010	-	Sistemi i Llogarive Evropiane (European System of Accounts)
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GFSM2014	-	Udhëzuesi për Statistikat e Financave Qeveritare
MF	-	Ministria e Financave
TKPK	-	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
:	-	Mungojnë të dhënat
—	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1. Hyrje	8
2. Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme	9
Tabela 1: Të hyrat e Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010 për periudhën 2020-2024	9
Grafiku 1. Të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 për vitin 2024	10
3. Shpenzimet - Qeveria e Përgjithshme	11
Grafiku 2. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 për vitin 2024	12
Tabela 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të klasifikimit COFOG për periudhën 2020 – 2024	13
Grafiku 3. Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të klasifikimit COFOG për vitin 2024....	14
Tabela 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës (2020-2024)	16

1. Hyrje

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2020 - 2024, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së.

Publikimi është përgatitur sipas Udhëzuesit të Fondit Monetar Ndërkombëtar për Statistikat e Financave Qeveritare (GFSM 2014) dhe sipas Sistemit të Llogarive Evropiane (ESA 2010).

Burimet e të dhënave janë: Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit dhe Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

2. Të hyrat - Qeveria e Përgjithshme

Gjithsej të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme për vitin 2024 ishin 3,222.7 milion Euro.

Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte, të cilat paraqesin 71% të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura 15%, pagesat për prodhimin jashtë tregut (shitjet) 4%, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.


Tab. 1: Të hyrat e Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010 për periudhën 2020-2024

(në milion Euro)

ESA2010	Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
D21	Tatimet në produkte	1,278.1	1,654.9	1,856.3	2,072.0	2,297.6
D211	Tatimi mbi vlerën e shtuar(TVSH)	739.0	984.4	1,156.2	1306.5	1450.6
D212	Tatimi dhe dogana në importe duke përfshirë TVSH	504.4	626.8	652.6	712.5	789.0
D2121	Detyrimet e importit	106.7	126.6	136.0	157.6	170.8
D2122	Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet	397.6	500.1	516.6	554.9	618.2
D214	Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	34.7	43.7	47.5	53.0	58.0
D29	Tatimet tjera në prodhim	45.1	40.1	58.8	48.6	21.0
D4	Të hyrat nga prona	14.4	42.9	34.2	70.0	94.7
D5	Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	264.4	330.6	399.7	474.8	490.6
D7	Transferta të tjera aktuale	58.4	43.8	54.0	117.6	65.8
F	Aktivitet dhe detyrimet financiare	463.3	268.3	112.3	-36.8	123.3
P131	Pagesat për prodhimin jashtë tregut (shitjet)	81.8	103.9	107.1	114.4	129.7
Gjithsej		2,205.4	2,484.6	2,622.4	2,860.7	3,222.7

Struktura e të hyrave të Qeverisë së Përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1.

Graf. 1: Të hyrat e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 për vitin 2024



3. Shpenzimet - Qeveria e Përgjithshme

Gjithsej shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në vitin 2024 ishin 3,189.3 milion Euro.


Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve 25%, kontributet sociale dhe përfitimet 24%, formimi i kapitalit bruto 16%, konsumi i ndërmjetëm 14%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategoritë tjera të shpenzimeve.

Tab. 2: Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 për periudhën 2020 – 2024

(në milion Euro)						
ESA2010	P ë r s h k r i m i	2020	2021	2022	2023	2024
D1	Kompensimi i punëtorëve	661.4	648.1	637.4	749.2	802.4
D3	Subvencionet	239.9	223.8	399.7	362.0	287.9
D4	Të hyrat nga prona	27.4	30.8	35.0	42.0	43.1
D6	Kontributet sociale dhe përfitimet	673.7	619.0	663.8	716.5	775.1
D7	Transferrat e tjera aktuale	31.3	52.5	47.8	52.3	126.4
D9	Transferrat kapitale	18.4	6.5	38.1	4.2	16.8
F	Aktivët dhe detyrimet financiare	117.1	132.2	136.4	48.2	133.8
NP	Posedimi i aktiveve jo-prodhuese	20.6	21.9	52.8	54.7	56.1
P2	Konsumi i ndërmjetëm	228.5	334.0	358.3	431.8	451.7
P5	Formimi i kapitalit bruto	313.9	307.5	254.6	464.6	496.2
Gjithsej		2,332.2	2,376.4	2,623.8	2,925.5	3,189.3

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është prezantuar në Grafikon 2.

Graf. 2: Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme bazuar në ESA2010 për vitin 2024



Llogaritë Qeveritare 2020 - 2024

Gjithsej shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të COFOG-ut në vitin 2024 ishin 3,189.3 milion Euro.


Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: mbrojtja sociale 24%, çështjet ekonomike 18%, shërbimet e përgjithshme 16%, arsimi 14%, shëndetësia 10%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në sektorët e tjerë.

Tab. 3: Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të klasifikimit COFOG për periudhën 2020 – 2024

(në milion Euro)					
Përshkrimi	2020	2021	2022	2023	2024
Shërbimet e përgjithshme	376.0	387.3	591.1	520.6	506.3
Mbrojtja	59.7	91.8	48.8	98.1	114.4
Rendi dhe siguria publike	204.8	210.5	213.9	266.4	291.3
Çështjet Ekonomike	462.4	358.5	409.2	477.1	560.1
Mbrojtja e Mjedisit	14.8	9.5	7.9	7.9	7.4
Strehim dhe pajisje për Komunitetin	37.2	39.3	47.0	50.5	58.5
Shëndetësia	261.7	275.8	238.1	298.3	320.0
Rekreacioni, kultura dhe Religjioni	51.8	60.7	54.1	101.9	104.8
Arsimi	313.1	340.3	346.7	395.1	446.9
Mbrojtja sociale	550.7	602.7	667.0	709.6	779.7
Gjithsej	2,332.2	2,376.4	2,623.8	2,925.5	3,189.3

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme është prezantuar në Grafikon 3.

Graf. 3: Shpenzimet e Qeverisë së Përgjithshme në bazë të klasifikimit COFOG për vitin 2024



Sistemi i fondit pensional

Sistemi pensional është i përbërë nga 3 shtylla. Secila prej tyre dallon në mënyrën se si financohen dhe në shtresën e popullatës të cilën e mbulojnë:

Shtylla e parë - është skema e asistencës themelore sociale, e cila është e zbatueshme jo vetëm për të moshuarit. Kjo është e integruar në Qeverinë Qendrore, që do të thotë se është pjesë përbërëse e Qeverisë. Pagesat pensionale nën këtë konsiderohen si dobi sociale të përfshira në shpenzimet të "Transferet rrjedhëse të Ekonomive Shtëpiake". Kjo është e financuar nga buxheti i Qeverisë së Përgjithshme.

Shtylla e dytë - është skema e kursimeve të detyrueshme pensionale. Kjo skemë ka filluar së funksionari në gusht të vitit 2002, kur punëdhënësit e mëdhenj dhe agjencitë shtetërore kane qene te obliguara për pagesen e kontributeve. Prej vitit 2003 skema e kursimeve të obligueshme është zgjeruar për të përfshirë të gjithë punonjësit e Kosovës e të vetëpunësuarit. Kursimet e detyrueshme pensionale administrohen dhe menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). TKPK pranon kontribute pensionale në vlerë prej 10% të pagës bruto të ndarë në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve (5%+5%), ndërsa për të vetëpunësuarit 10 % të të ardhurave të fituara. TKPK i investon këto mjete përmes menaxhuesve të specializuar të mjeteve.

Shtylla e tretë - Nenet e Rregullores së pensioneve mbi skemat vullnetare sigurojnë që këto skema të jenë të sigurta, të financuara në mënyrë adekuate dhe transparente. Skemat e pensioneve vullnetare paraqesin opsion për biznese dhe institucione të ndryshme financiare dhe mund të financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe/ose të të punësuarve. Departamenti i Pensioneve në [BQK](#) liçencon dhe monitoron skemat vullnetare.

Sistemi kryesor pensional është regjistruar jashtë Qeverisë. Kontributet e pagesave të pensioneve janë rrjedha në mes të Ekonomive shtëpiake dhe sektorit të korporatave financiare.

Nga këndvështrimi ekonomik nuk duket të jetë plotësisht e kënaqshme që sistemi kryesor pensional i detyrueshëm nuk është reflektuar në llogarinë e Qeverisë. Kështu që publikimet e ASK-së për Llogaritë Qeveritare, në parim përmbajnë një pasqyrë, të situatës së shtyllës së financuar (kontributet, të hyrat e aseteve, pagesat dhe asetet)

Tab. 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës (2020-2024)

(në milion Euro)

Vitet	Kontributet e mbledhura pensionale	Kthimet e investimeve	Provizionet, kthimet dhe pagesat tjera	Salldo e aseteve pensionale
2020	194	72	244	1,965
2021	213	227	78	2,328
2022	241	-119	64	2,386
2023	286	88	38	2,723
2024	316	247	83	3,202

Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Historiku i shkurtër - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional dhe i pavarur që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore në nivel kombëtar. E themeluar që nga viti 1948, ASK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimore, duke vepruar në përputhje me strukturat shtetërore të kohës.

Pas një ndërprerjeje në periudhën 1989–1999, ASK rifilloi aktivitetin më 2 gusht 1999 si institucion i pavarur brenda Ministrisë së Administratës Publike. Nga 1 korriku 2020 gati për dy vite të plota, veproi në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Financimi i ASK-së bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorë ndërkombëtarë për projekte specifike dhe ndihmë teknike.

Legjislacioni: ASK vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikën Zyrtare dhe ndryshimeve përkatëse përmes Ligjit Nr. 06/L-058. Struktura organizative përfshin Departamente Prodhuese si Departamenti i Statistikave Ekonomike, Departamenti i Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave Sociale, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, Departamentet mbështetëse si Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informativë, Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, Departamenti i Administratës. Në kuadër të Agjencisë veprojnë edhe Zyrat Rajonale në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Misioni i ASK-së - Të ofrojë të dhëna statistikore cilësore dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit – institucione qeveritare, komunitetin akademik, sektorin privat dhe publikun e gjerë – në mbështetje të vendimmarrjes, planifikimit dhe zhvillimit të politikave në të gjitha nivelet.

Objektivi i ASK-së - Të prodhohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme. Përfshirë shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikat janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave.

Vizioni i ASK-së - Të jetë burimi kryesor dhe më i besueshëm i statistikave zyrtare në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur vendimmarrjen, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimet - Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës sidomos me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Bankën Qendrore të Kosovës ku edhe përbejnë Sistemin Statistikor të Kosovës. Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organizata ndërkombëtare si: EUROSTAT, FMN, Banka Botërore, INSTAT, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, VIIES, IMF, ILO STAT, UNODC, ETF, IA, OECD si dhe me institucionet statistikore të rajonit.

Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – një projekt kyç për hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

ASK mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes rrjetit të njësive raportuese dhe qarqeve statistikore, duke siguruar të dhëna të dorës së parë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>
- © Agjencia e Statistikave të Kosovës
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.